



REPUBLIKA E SHqipërisë

PARTNERITETI PËR QEVERISJEN E HAPUR

PLANI I TRETË KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR QEVERISJEN E HAPUR PËR

SHQIPËRINË 2016 - 2018

Open
Government
Partnership



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
PËRPPJEKJET E DERITANISHME TË QEVERISË SË HAPUR	4
NISMAT E PLANIT KOMBETAR TE VEPRIMIT	5
1.Qeverisje e Hapur për të rritur Qasjen në Informacion	6
1.1 Përmirësimi i portalit me të dhënat e koordinatorëve të të drejtës për informim si dhe programeve të transparencës - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.....	6
1.2 Transparenca buxhetore - Ministria e Financave.....	7
1.3 Regjistri i integruar të banesave të shtetasve – Ministria e Punëve të Brendshme.....	11
1.4 Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike – AKSHI.....	13
1.5 Arkiva digjitale - Ministria e Zhvillimit Urban.....	15
1.6 Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve për kërkimin shkencor në Shqipëri-IDM.....	16
1.7 Angazhim për të publikuar online ne sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacionin qendror dhe vendor – INFOCIP.....	18
1.8 Angazhim për Standarte Open Contracting, publikim në formatin Open Data të kontratave publike – AIS.....	20
2. Qeverisje e Hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta	24
2.1 Zbatimi i Ligjit “Për mbrojtjen e Sinjalizuesve”, ngritje kapacitetesh dhe aktesh nënligjore - Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.....	25
3. Qeverisje e Hapur për të modernizuar shërbimet publike.....	26
3.1 Shtimi i shërbimeve elektronike – AKSHI/të gjitha institucionet.....	28

3.2 Krijimi i sistemit multifunksional të qendëruar për lejet e ndërtimit – AKSHI.....	29
3.3 Prezantimi dhe shtimi i sporteve digjitale – AKSHI.....	31
3.4 Standardizimi i Kartelës Informative – ADISA	33
3.5 Karta e Qytetarit – ADISA.....	35
3.6 Sistemi elektronik i regjistrimit të recetave elektronike në Republikën e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë.....	37
4.Qeverisje e Hapur për të mbrojtur mjedisin.....	40
4.1 Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve - Ministria e Mjedisit.....	42
4.2 Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit - Ministria e Zhvillimit Urban.....	47

PARATHËNIE

Pas nisjes zyrtare të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur, Qeveria shqiptare mbështeti vlerat e promovuara nga kjo iniciativë shumëpalëshe. Partneriteti për Qeverisjen e Hapur (PQH, ang. OGP) është një ndër instrumentet më të rëndësishme për të nxitur transparencën qeveritare në nivel global, për të rritur pjesëmarrjen qytetare në jetën publike dhe për të përdorur teknologjitë e reja për të përmirësuar efijencën administrative dhe luftuar korrupsionin.

Me rritjen e kërkesave nga publiku për një qeverisje transparente dhe llogaridhënëse, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një komunikim më të mirë dhe të hapur me qytetarët dhe me shoqërinë civile.

Gjatë formimit të qeverisë së re në Shtator 2013, Kryeministri i Shqipërisë Z. Edi Rama, theksoi ndër të tjera "krijimin e një shoqërie të drejtë", duke deklaruar qeverisjen e hapur dhe transparente si një nga faktorët kyç të agjendës kombëtare. Në këtë perspektivë janë duke u zhvilluar politika të ndryshme për të arritur qeverisje të hapur.

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, rritjen e integritetit publik dhe menaxhimin në mënyrë efektive të burimet publike, Qeveria Shqiptare paraqet këtë plan kombëtar me qëllim rritjen e transparencës, pjesëmarrjen qytetare dhe përgjegjësinë e qeverisë. Për më tepër, Ne jemi duke bërë përpjekje të pareshtura drejt realizimit të një qeverie të hapur dhe mbi të gjitha, një kombi të përparuar. Ky plan veprimi është rezultat i një procesi të gjerë konsultimi me shoqërinë civile.

PËR PJEKJET E DERITANISHME TË QEVERISJES SË HAPUR

Plani i parë i Veprimit për periudhën 2011-2013 i PQH/OGP u fokusua kryesisht në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në menaxhimin e shërbimeve të burimeve publike, duke zbatuar masat në fushën e transparencës fiskale, qasjen në informacion, përdorimin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e zhvillimit të politikave publike.

Angazhimet e Qeverisë Shqiptare adresuan kryesisht tri nga pesë sfidat e mëdha të PQH/OGP: rritja e integritetit publik, përmirësimi i shërbimeve publike, dhe menaxhimi i burimeve publike në mënyrë më efikase. Ka qenë një total prej 30 (tridhjetë) angazhimesh të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare për afatin 2012 – 2013. Raport progresi i IDM 2012/2013 për Shqipërinë tregoi se Qeveria ka zbatuar tashmë 16 nga 30 angazhimet.

Puna për përgatitjen e Planit të Dytë Kombëtar të Veprimit filloi në Janar 2014 me krijimin e një grupi pune të përbërë nga zëvendës ministrat e secilës Ministri dhe nga Drejtorët e Institucioneve dhe Agjencive Publike më të rëndësishme në Shqipëri.

Në muajin Mars, në bashkëpunim me shoqërinë civile u organizua Konferenca e parë, në të cilën grupeve të punës të përbërë nga shoqëria civile dhe përfaqësues të shtetit të përfshirë drejtpërdrejtë në angazhimet e propozuara, ju shpërndanë angazhimet e secilës ministri.

Pas Konferencës u krijua Koalicioni i Shoqërisë Civile për Partneritetin për Qeverisje të Hapur dhe paraqiti 25 rekomandime në lidhje me përmirësimin e Planit të Dytë të Veprimit për Shqipërinë.

Afatet kohore, plani i veprimit, 25 rekomandimet dhe secili angazhim u publikuan për konsultim publik në faqen zyrtare të MIAP.

Pas fazës së konsultimit publik, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike organizoi një takim të dytë me shoqërinë civile ku komentet dhe sugjerimet e marra nga publiku i gjerë gjatë fazës së konsultimeve, u diskutuan, konsultuan dhe u integruan në një draft plan veprimi.

NISMAT E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Angazhimet e reja të Qeverisjes së Hapur përfshijnë zgjerimin e angazhimeve fillestare, si dhe nisjen e iniciativave të reja.

Në 23 Mars 2016, Shqipëria lançoi Forumin e Aktorëve të Interesit/OpenAlb, një mekanizëm që siguron zbatimin e suksesshëm të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH) në vend. Forumi OpenAlb ka një përfaqësim të barabartë të përfaqësuesve të zyrtarëve qeveritarë dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile, si i tillë anëtarët e tij angazhohen në konsultime periodike gjatë hartimit të planit Kombëtar të Veprimit si dhe në vlerësimin e rezultateve të arritura nga angazhimet e planit të veprimit.

Plani i veprimit që vijon paraqet rezultatin e bashkëpunimit të ngushtë me anëtarët e shoqërisë civile dhe parashikon angazhimet që përfshijnë vetë ata gjatë fazës së implementimit të secilit angazhim.

Si anëtare e PQH që prej vitit 2011, Shqipëria sapo përfundoi zbatimin e Planit të II-të Kombëtar të Veprimit si dhe është duke përgatitur raportin e vetëvlerësimit. Ky Forum synon të sjellë së bashku përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në një dialog me qëllim ndërmarrjen e angazhimeve konkrete për të nxitur reformat për një qeverisje të hapur dhe inovative në nivel kombëtar.

Forum i është angazhuar në promovimin e nismës së partneritetit për Qeverisje të Hapur, konsultimin dhe hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit dhe Monitorimin e Zbatimit të Angazhimeve, me qëllim shtrirjen e praktikës përtej bazës aktuale të vendit në fushën e transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të qytetarëve.

Administrata do të vazhdojnë të punojë së bashku me publikun dhe organizatat e shoqërisë civile për të zbatuar secilin prej këtyre angazhimeve gjatë dy viteve të ardhshme.

1. QEVERISJE E HAPUR PËR TË RRRITUR QASJEN NË INFORMACION

1.1 Përmirësimi i portalit me të dhënat e koordinatoreve të të drejtës për informim si dhe programeve të transparencës - Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale

Aktualisht Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale ka ngritur portalin qendror për të drejtën e informimit nëpërmjet të cilit qytetarët do të kenë mundësi të bëjnë kërkesa për informim online si dhe nëse kjo e drejtë nuk përmbushet ato do të kenë mundësi të bëjnë ankesa online. Në këtë portal do të gjendet një baze të dhënash e zgjeruar me programet e transparencës së Autoriteteve publike, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion publik pa kërkesë, si dhe të dhëna për koordinatorët e të drejtës për informim dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve.

Në kuadër të këtij plani veprimi, ky portal do të përmirësojë modulën e publikimit të ankesave dhe përgjigjeve që qytetarët i kanë drejtuar institucioneve në kuadër të programeve të transparencës; portali gjithashtu do të qëndrojë i përditësuar me të dhënat më të fundit për koordinatorët në çdo institucion.

Ky angazhim nënkupton ofrimin e mundësisë se një gjurmim elektronik të kërkesave për informim dhe ankesave nga vete subjektet e interesuar. Në këtë portal do të gjendet një baze të dhënash e zgjeruar me programet e transparencës së Autoriteteve publike, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion publik pa kërkesë, si dhe të dhëna për koordinatorët e të drejtës për informim dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve.

PËRMIRËSIMI I PORTALIT ME TË DHËNAT E KOORDINATORËVE TË TË DREJTËS PËR INFORMIM SI DHE PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS		
Institucioni udhëheqës		Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Fondacioni "SOROS"
Status quo ose problemi/çështja që adresohet		Mungesa e një rregjistri qendror për kërkesat, mungesa e një database me të dhënat e koordinatoreve të të drejtës për informim si dhe programeve të transparencës.

Objektivi kryesor	Krijimi portalit qëndror për të drejtën e Informimit nëpërmjet të cilit qytetarët kanë mundësi të bëjnë kërkesa për informim online si dhe nëse kjo e drejtë nuk përmbushet ato do të kenë mundësi të bëjnë ankesa online. Në këtë portal gjendet një database e zgjeruar me programet e transparencës së Autoriteteve publike, nëpërmjet të cilëve sigurohet informacion publik pa kërkesë, si dhe të dhëna për koordinatorët e të drejtës për informi dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve.				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
			X		
Është e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X	X		X	
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	
Krijimi i portalit	Angazhim në vazhdim	Shtator 2015		Maj 2016	
Përditësimi i portalit nga ana e Autoriteteve publike		Maj 2016		Në vazhdim	

1.2 *Transparenca buxhetore - Ministria e Financave*

Transparenca në financat publike është një element kryesor i qeverisjes, në mënyrë që informacioni mbi buxhetin të publikohet në kohë, të jetë lehtësisht i aksesueshëm si dhe i qartë për qytetarët. Ky angazhim çon më tej drejt stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, si dhe për norma më të larta të rritjes ekonomike. Përpos kësaj, ajo ndihmon për të përmirësuar efikasitetin mbi shpenzimet publike.

Ministria e Financave i ka kushtuar një vëmendje shumë të madhe transparencës në buxhetim, duke e vendosur atë një nga prioritetet e saj, të materializuar në Strategjinë e Financave Publike 2014-2020.

Përmirësimi i transparencës buxhetore përmes këtij angazhimi synohet të arrihet duke:

- Përgatitur të gjithë dokumentet e nevojshëm buxhetor të kërkuar, në një format të tillë që struktura e tyre të jetë e qartë dhe e kuptueshme për qytetarët.
- Publikuar në kohë këto dokumente.
- Publikuar në faqen online të Ministrisë së Financave dhe në media të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga Ministria, përfshirë seancat dëgjimore për programimin afatmesëm buxhetor për të arritur pjesëmarrje aktive të përfaqësuesve nga organizata të ndryshme me bazë qytetarët, NGO, shoqëria civile, nga njësitë e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor.

TRANSPARENCA BUXHETORE		
Institucioni udhëheqës		Ministria e Financave
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Ministria e Financave
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Partners Albania, AIS, ETJ.
Status quo ose problemi/çështja që adresohet		<p>Ministria e Financave, në kuadër të aktiviteteve të Public Finance Management (PFM), përmbushjes së aktiviteteve/dokumentave buxhetor të cilat janë kritere dhe kërkojnë nga OBI (Open Budget Index), në mënyrë që informacioni mbi buxhetin të publikohet në kohë, të jetë lehtësisht i aksesueshëm si dhe i qartë edhe për qytetarët, ka ndërmarrë për të vazhduar me ecurinë e mëtejshme mbi Transparencën Buxhetore.</p> <p>Transparenca është një nga 8 parimet themelore të “Qeverisjes së mirë” (Good Governance). Sipas OECD-s transparenca buxhetore është përkufizuar si “ zbulim i plotë i të gjitha informacioneve të rëndësishme buxhetore në kohë dhe në mënyrë sistematike”. Transparenca në financat publike është një element kryesor i qeverisjes, e cila çon më tej drejt stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, si dhe determinante për norma më të larta të rritjes ekonomike. Përpos kësaj, ajo ndihmon për të përmirësuar efikasitetin mbi shpenzimet publike, ndërsa rritja e jotransparencës çon drejt zvogëlimit të disiplinës fiskale.</p> <p>Ministria e Financave i ka kushtuar një vëmendje shumë të madhe transparencës në buxhetim, duke e vendosur në një nga prioritetet e saj, të materializuar në Strategjinë e Financave Publike 2014-2020.</p>

	<p>Mungesa e transparencës buxhetore sjell: mungesë të disponeshmërisë së informacionit të kërkuar, mungesë informacioni në publik, zvogëlimin e besimit që kanë qytetarët për mënyrën sesi shpenzohen fondet publike, etj. Probleme shfaqen edhe kur kemi mungesë të publikimit të raporteve të monitorimit, raportit të mes-vitit, raportit të fundvitit, “Buxheti i Qytetarit” i cili është një pamflet me gjuhë të thjeshtë, që ilustron aspektet kryesore të buxhetit vjetor, të cilët duhet të publikohen në kohë dhe sigurisht, të kuptueshëm për qytetarët.</p> <p>Megjithatë, edhe përpos masave të marra në këtë kontekst, Shqipëria, sipas raportit të “Open Budget Survey 2015” rezulton ndër shtete që ka pasur rënie në transparencën e buxhetit të shtetit, e rankuar e parafundit në rajon, me një pikësim me 38 pikë nga 100 të mundshme. Përpos kësaj, është e nevojshme që të avancohet më tej me përmirësimin dhe rritjen e Transparencës Buxhetore.</p>				
Objektivi kryesor	<p>Qëllimi bazë i kësaj veprimtarie është rritja e Transparencës Buxhetore duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatitur të gjithë dokumentat e nevojshëm buxhetor të kërkuar, në një format të tillë që struktura e tyre të jetë e qartë dhe e kuptueshme për qytetarët. • Publikuar në kohë këto dokumenta. • Publikimi në faqen online të MoF dhe në media i të gjitha aktiviteteve të zhvilluara nga Ministria. • Pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve nga organizata të ndryshme me bazë qytetarët, NGO, shoqëria civile, nga njësitë e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor. 				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
		X	X		
	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion

Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	X		X	
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit	Data e mbarimit	
<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e dokumentave kyç të buxhetit si: Projektligjin e Buxhetit vjetor, Ligji i miratuar i buxhetit, Programi Buxhetor Afatmesëm, raportet e monitorimit, raporti i mes-vitit, raporti i fundvitit, “Buxheti i Qytetarit”, risi nga viti i klauar por që duhet të përmirësohet për vitet në vazhdim në mënyrë që kjo broshurë të jetë sa më e thjeshtë dhe sa më e kuptueshme për qytetarët; • Publikimi në kohë dhe konform rregullave, i dokumentave buxhetor; • Organizimi i takimeve periodike në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor 	Angazhim i vazhduar	Shtator 2013	Vazhdim	

<p>Afatmesëm 2017 – 2019, deri në publikimin e dokumentit final të tij, me përfaqësues të qeverisjes qendrore, vendore dhe grupeve të ndryshme të interesit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i takimeve me pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të interesit mbi Ligjin e Ri për financat vendore; • Raporte monitorimi për çdo ministri çdo katër muaj; 			
--	--	--	--

1.3 Regjistri i integruar të banesave të shtetasve – Ministria e Punëve të Brendshme

Regjistrimi i banesave të shtetasve do të bëjë të mundur që shumë shërbime që qytetarëve mund t'i ofrohen pranë banesave, të ri dimensionohen pas krijimit të këtij regjistri.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij shërbimi është regjistrimi i banesave të emigrantëve shqiptarë. Kjo do të mundësojë një informacion të rëndësishëm me përdorim të gjerë për institucionet shtetërore dhe private (vota e emigrantëve, gjobat në shtëpi dhe shumë përdorime të tjera).

I gjithë procesi do të garantojë përfshirjen e qytetarëve për të verifikuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave, një shembull për këtë është se të dhënat për regjistrimin e emigrantëve do të bëhen me vetë deklaram. Po ashtu, feedback nga qytetarët do të merret përmes zyrave urbane dhe zyrave të gjendjes civile të shtrira në të gjithë vendin.

Regjistri i Integruar të Banesave të Shtetasve						
Institucioni udhëheqës		Ministria e Punëve të Brendshme				
Pjesëmarrës të tjerë	Qeveria	Ministria e Punëve të Brendshme				
	Shoqëria Civile, Sektori Privat					
Status quo ose problemi / çështja që adresohet		<p>Regjistrimi i banesave të shtetasve është një përmirësim i rëndësishëm për shërbimet publike.</p> <p>Shumë shërbime që qytetarëve mund ti ofrohen pranë banesave do të ridimensionohen pas krijimit të këtij regjistri.</p> <p>Një aspekt i këtij shërbimi është dhe regjistrimi i banesave të emigrantëve shqiptarë.</p> <p>Kjo do të mundësojë një informacion të rëndësishëm me përdorim të gjerë për institucionet shtetërore dhe private (vota e emigrantëve, gjobot në shtëpi dhe shumë përdorime të tjera).</p>				
Objektivi kryesor		<p>Shërbim cilësor ndaj qytetarit nëpërmjet regjistrimit të banesave.</p> <p>Shkrirja e Regjistrimit Kombëtar të Adresave me Regjistrin e Gjendjes Civile.</p> <p>Popullimi i adresave të banorëve</p>				
Sfida e OPG-së që preket nga angazhimi		Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
		X	X			X
Është e rëndësishme për		Transparencë	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion

përmirësimin e:	X	X		
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit	Data e mbarimit	Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit
<ul style="list-style-type: none"> • Ngritje dhe përditësim • Popullimi dhe identifikimi 	Angazhim i ri	Qershor 2016	2017	

1.4 Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

Krijimi i regjistrimit për njoftimin dhe konsultimin publik vjen në zbatim të Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Në këtë kuadër, ky sistem është konceptuar si një seksion në formën e një forumi virtual interaktiv në unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.al. Çdo institucion vendimmarrës dhe ligjvënës, nëpërmjet një përdoruesi që do të jete në rolin e koordinatorit të institucionit, do të publikojë dhe hedhë për konsultim me qytetarët dhe grupet e interesit çdo projektvendim apo projektligj përpara miratimit të tij.

Përfshirja e këtij regjistri në portalin unik qeveritar e-Albania.al, dhe përfshirja e sistemit të konsultimit publik brenda tij do të rrisë ekspozimin dhe aksesin e qytetarëve në këtë sistem.

Ky investim synon rritjen e transparencës dhe rritjen e angazhimit publik në qeverisje për plotësimin e nevojave funksionale për krijimin e sistemit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Krijimi i Regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike		
Institucioni udhëheqës	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Ministri Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike si dhe Ministrinë e Linjes
	Shoqëria Civile, Sektori	Me impakt të gjërë në shoqërinë civile

	privat				
Status quo ose problemi/çështja që adresohet	<p>Krijimi i regjistrit për Njoftimin dhe Konsultimin publik vjen në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.</p> <p>Ne këtë kuadër, ky sistem është konceptuar si një seksion në formën e një forumi virtual interaktiv në portalin e-Albania. Cdo institucion vendimmarrës dhe ligjvënës, nepermjet një përdoruesi që do të jetë në rolin e koordinatorit të institucionit, do të publikojë dhe hedhë për konsultim me qytetarët dhe grupet e interesit çdo vendim apo ligj përpara miratimit të tij.</p> <p>Ekzistenca e portalit unik qeveritar e-Albania, dhe përfshirja e sistemit të konsultimit publik brenda portalit e-Albania do të rrisë ekspozimin dhe aksesin e qytetarëve në këtë sistem.</p> <p>Ky investim synon rritjen e transparencës dhe rritjen e angazhimit publik në qeverisje për plotësimin e nevojave funksionale për krijimin e sistemit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.</p>				
Objektivi kryesor	<p>Ky regjistër ka për qëllim të shërbejë si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.</p>				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti të sigurt
	X				
Është e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Inovacion dhe teknologji
	X			X	X

Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit	Data e mbarimit	Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit
• Sistem i ngritur e funksional	Angazhim i ri	2016	2017	Sistem i ngritur e funksional

1.5 Arkiva digjitale - Ministria e Zhvillimit Urban

Nisma e propozuar nga Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (AQTN) ka si objektiv të përgjithshëm ndjekjen dhe përputhshmërinë me zhvillimet e agjendës digjitale në Shqipëri dhe kalimin e AQTN në një stad të avancuar dhe të pranueshëm teknologjik, referuar Enteve analoge në vendet e tjera të BE-së, si dhe Enteve të ngjashme në vend. Arkivi duhet të kthehet në një aset nga ana teknologjike dhe e aksesit, të konvertueshëm dhe të krahasueshëm me arkiva analoge evropiane. Përmirësimi dhe efektiviteti i shërbimit të ofruar ndaj qytetarit, nëpërmjet:

- Ofrimin e shërbimeve online përmes aksesit në internet/intranet të qytetarëve apo enteve e palëve të tjera të interesuara që kërkojnë këto shërbime, mundësi aksesi online të materialit.
- Krijimin e mundësive teknologjike dhe infrastrukturore për publikim shërbimesh, përfitim në kohë reale të tyre, ulje të kostove të shërbimeve, kursim energjish njerëzore për procese automatike.
- Uljen e përdorimit të dokumentacionit dhe materialeve të tjera arkivore origjinale përmes rritjes së shkallës së përdorimit të tyre në formë elektronike.

NGRITJA E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË ARKIVËS DIXHITALE		
Institucioni udhëheqës		Ministria e Zhvillimit Urban, Arkivi Qendror Teknik i Njërtimit
Pjesëmar rës të tjerë	Qeveria	Ministria e Zhvillimit Urban, Arkivi Qendror Teknik i Njërtimit
	Shoqëria Civile, Sektori	

	privat				
Status quo ose problemi/çështja që adresohet	<p>Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) dhe Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit (AQTN), në kuadër të reformës së dixhitalizimit, të shërbimeve Online në portalin e-albania, si dhe të shërbimit “single window”, ka ndërmarrë nismën për ngritjen e Databazës shtetërore për Arkiven Dixhitale. Si institucion i vetëm në Republikën e Shqipërisë, AQTN është institucioni që mbledh dhe Administron materialin teknik të ndërtimit. Kjo bën që shumë qytetarë duhet të udhëtojnë drejt Tiranës për tu paraqitur pranë arkivit për të aplikuar për marrjen e dokumentacionit arkivor.</p> <p>Si pasojë kjo sjell:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kosto tek qytetari; Vonesa në marrjen e materialit të kërkuar (sepse qytetarit do i duhej të udhëtonte personalisht); Pagesat bëhet vetëm nëpërmjet bankave. <p>Projekti i propozuar ka si objektiv të përgjithshëm ndjekjen dhe përputhshmërinë me zhvillimet e axhendës dixhitale në Shqipëri dhe kalimin e AQTN në një stad të avancuar dhe të pranueshëm teknologjik, referuar Enteve analoge në vendet e tjera të BE-së, si dhe Enteve të ngjashme në vend.</p> <p>Arkivi duhet të kthehet në një aset nga ana teknologjike dhe e aksesit, të konvertueshëm dhe të krahasueshëm me arkiva analoge evropiane.</p>				
	Objektivi kryesor	<p>Qëllimi bazë i ndërtimit të këtij sistemi është përmirësimi dhe efektiviteti i Shërbimit të ofruar ndaj qytetarit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Ofrimin e shërbimeve online përmes aksesit në Internet/Intranet të qytetarëve apo enteve e palëve të tjera të interesuara që kërkojnë këto shërbime, mundësi aksesit online të materialit. Krijimin e mundësive teknologjike dhe infrastrukturore për publikim shërbimesh, përfitim në kohë reale të tyre, ulje të kostove të shërbimeve, kursim energjish njerëzore për procese automatike. Uljen e përdorimit të dokumentacionit dhe materialeve të tjera arkivore origjinale përmes rritjes së shkallës së përdorimit të tyre në formë elektronike. 			
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
	X	X			

	Transparencës	Përgjegjësisë	Pjesëmarrje s qytetare	Teknologji dhe inovacion
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	X	X		

1.6 Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve për kërkimin shkencor në Shqipëri - IDM

Qeveria Shqiptare do të angazhohet në maksimizimin e aksesit të kërkimit shkencor të financuar nga fondet publike dhe jopublike për të nxitur një bashkëpunim më të madh midis komunitetit shkencor, institucioneve publike dhe sektorit privat. Aktivitetet që propozohen në këtë kuadër:

Zhvillimi, miratimi dhe promovimi i standardeve për Open Science në Shqipëri.

Plotësimi i legjislacionit përmes një akti nënligjor për të mundësuar kërkimin me një ndalesë për publikimet dhe të dhënat që rezultojnë nga punimet shkencore ndërmarra nga institucionet dhe hulumtuesit shqiptarë (të mbështetur me financime Shqiptare dhe të tjera).

KRIJIMI I NJE DATABASE PER ARKIVIMIN DHE PUBLIKIMIN E FONDEVE DHE PROGRAMEVE PER KERKIMIN SHKENCOR NE SHQIPERI	
Institucioni udhëheqës	Ministria e Arsimit dhe Sportit
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
	Shoqëria Civile, Sektori privat Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Status quo ose problemi/çështja që adresohet	Në shqipëri ka një nivel shumë të ulët bashkëpunimi (ose inekzistent) të bashkëpunimit midis komunitetit shkencor dhe sektorit privat si dhe të komunitetit shkencor dhe institucioneve publike në lidhje me politikë-bërjen e bazuar në evidencë. Një nga problematikat kryesore është edhe mungesa e njohjes së produkteve dhe rezultateve të kërkimit shkencor që

	<p>prodhohet në Shqipëri.</p> <p>Aktualisht në Shqipëri ekzistojnë një numër programesh (me fonde publike ose donatorësh) që mbështesin kërkimin shkencor në shqipëri. Por mungesa e një portali unik, ku të pasqyrohen të gjitha produktet e kërkimit shkencor, pengon në zhvillimin e këtij bashkëpunimi.</p>				
Objektivi kryesor	<p>Objektivi: Qeveria Shqiptare do të angazhohet në maksimizim në aksesit të kërkimit shkencor të financuar nga fondet publike dhe jo – publike për të nxitur një bashkëpunim më të madh midis komunitetit shkencor, institucioneve publike dhe sektorit privat.</p> <p>Aktivitete që propozohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi, miratimi dhe promovimi i standarteve për Open Science në Shqipëri. - Krijimi i një shërbimi online për të mundësuar kërkimin me një ndalesë për publikimet dhe të dhënat që rezultojnë nga punimet shkencore ndërmarrë nga institucionet dhe hulumtuesit shqiptarë (të mbështetur me financime Shqiptare dhe të tjera) 				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
		X	X		
	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion

Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	X	X	X	
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit	Data e mbarimit	
Akt nenligjor i miratuar.	Angazhim i ri	2016	Dhjetor 2017	

1.7 Angazhim për të publikuar online në sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacioni qendror dhe vendor - INFOCIP

Infocip konstaton se në mënyrë të posaçme, se aksesin në legjislacionin qendror dhe atë vendor është një shërbim publik i cili nuk nevojë për përmirësime, pavarësisht kërkesave ligjore gjithnjë e më eksplicite. Angazhimi për të publikuar online në sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacionin qendror dhe vendor.

Lidhur me legjislacionin qendror, qeveria angazhohet në publikimin e legjislacionit në faqet zyrtare të Ministrive të Linjës, pa pagesë, në rubrikën: Legjislacion.

Lidhur me legjislacionin vendor, Infocip ofron portalin vendime.al si një platformë kombëtare, unike në llojin e vet, e cila mund të adoptohet edhe si mekanizëm raportimi.

PUBLIKIMI ONLINE NE SISTEME TË HAPURA DHE PA PAGESË LEGJISLACIONI QENDROR DHE VENDOR		
Institucioni udhëheqës		Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	
	Shoqëria Civile, Sektori privat	INFOCIP

Status quo ose problemi/çështja që adresohet	INFOCIP konstaton se në mënyrë të posacme, se aksesi në legjislacionin qëndror dhe atë vendor është një shërbim publik i cili ofrohet keq dhe pa cilësi në gjithë këto vite, pavarësisht kërkesave ligjore gjithnjë e më eksplicite. INFOCIP propozon që Shqipëria të marrë angazhim për të publikuar online ne sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacioni qendror dhe vendor. Për të parën, një system koherent duhet të adoptohet (I vjetri ka mungesë të theksuar efikasitete dhe koherence). Për të dytën, INFOCIP ofron VENDIME.AL si një platform kombëtare, unike në llojin e vet, e cila të adoptohet, raportohet si një kotribut direkt i shoqërisë civile në kuadër të ri të angazhimit, por edhe te mekanizmit të raportimit.				
Objektivi kryesor	Shqipëria të marrë angazhim për të publikuar online ne sisteme të hapura dhe pa pagesë legjislacioni qendror dhe vendor.				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
			X		
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	
	X	X			
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	
Krijimi i portalit	Angazhim i ri	Në vijim		Në vijim	
Përditësimi i portalit nga ana e Autoriteteve publike					

1.8 Angazhim për Standarte Open Contracting, publikim në formatin Open Data të kontratave publike - AIS

Organizata AIS si organizatë promotorë e të dhënave të hapura dhe transparente, njëkohësisht e angazhuar si anëtare e koalicionit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (ang. OGP) për Shqipërinë,

propozoi disa angazhime për Qeverinë dhe Partnerët e saj, për tu bërë pjesë në Plan Veprimin 2016 – 2018, ndër të cilat: publikimi online i kontratave koncesionare dhe PPP që kanë palë shtetin shqiptar.

Institucioni qeveritar i angazhuar për këtë qëllim është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Qeveria Shqiptare të angazhohet në përdorimin e standardeve Open Contracting. Ky është një trend aktual i përpjekjeve të shteteve dhe aktorëve të transparencës për informacion të hapur mbi kontratat publike dhe mënyrën se procedohet deri në finalizimin e tyre. Regjistri Koncesionar që do të ndërtohet në bazë të Ligjit për Koncesione dhe PPP, si dhe VKM-së të konsiderohet për tu realizuar në një format Open Data. Kjo duke garantuar të dhëna të sekretit tregtar apo intelektual. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve ka ndërmarrë angazhimin për krijimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat në zbatim të Ligjit 125/2013, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 211 datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/PPP”. Ky institucion po mbledh aktualisht të dhëna për të gjitha kontratat koncesionare dhe PPP nga të gjithë autoritetet kontraktore në Republikën e Shqipërisë. Regjistri që do të krijohet si rezultat i këtij angazhimi do të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë.

PUBLIKIMI ONLINE I KONTRATAVE KONCESIONARE DHE PPP QË KANË PALË SHTETIN SHQIPTAR	
Institucioni udhëheqës	
Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, MZHETTS	
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria Shoqëria Civile, Sektori privat
Status quo ose problemi/çështja që adresohet	AIS
	Qeveria Shqiptare të angazhohet në përdorimin e standardeve Open Contracting. Ky është një trend aktual i përpjekjeve të shteteve dhe aktorëve të transparencës për informacion të hapur mbi kontratat publike dhe mënyrën se procedohet deri në finalizimin e tyre. Regjistri Koncesionar që do të ndërtohet në bazë të Ligjit për Koncesione dhe PPP, si dhe VKM-së të konsiderohet për tu realizuar në një format Open Data. Kjo duke garantuar të dhëna të sekretit tregtar apo intelektual. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve ka ndërmarrë angazhimin për krijimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat në zbatim të Ligjit 125/2013, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 211 datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/PPP”. Ky institucion po mbledh aktualisht të dhëna për të gjitha kontratat koncesionare dhe PPP nga të gjithë autoritetet kontraktore në Republikën e Shqipërisë. Regjistri që do të krijohet si rezultat i këtij angazhimi do të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë.

Objektivi kryesor	Shqipëria të marrë angazhim për të publikuar ko. ntratat koncesionare dhe PPP.				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
			X	X	
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X	X			X
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	
Regjistri elektronik online dhe funksional.	Angazhim i ri	2016			

2. QEVERISJE E HAPUR PËR KRIJIMIN E KOMUNITETEVE TË SIGURTA

2.1 Zbatimi i Ligjit “Për mbrojtjen e Sinjalizuesve”, ngritje kapacitetesh dhe plotësim i akteve nënligjore - Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore

Ky angazhim ka si objektiv rritjen e numrit të denoncimeve për rastet e korrupsionit në autoritetet publike dhe mbrojtjen e informatorëve.

Ka përfunduar puna dy vjeçare për hartimin e projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, si një mjet i rëndësishëm parandalues dhe raportues i praktikave korruptive brenda autoriteteve publike dhe subjekteve private. Projektligji është miratuar në Këshillin e Ministrave në 16 dhjetor 2015; në datë 17 shkurt 2016, projektligji u prezantua nga Ministri Çuçi në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku u zhvilluan edhe diskutimet e para në parim mbi përmbajtjen e projektligjit mes anëtarëve të Komisionit dhe përfaqësuesve të MSHCV-së.

Ne date 1 mars 2016, projektligji u diskutua në parim në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare dhe u miratua në parim.

Në 7 mars 2016, në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dhe në përputhje me Rregulloren e Parlamentit, u zhvillua seance dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura, organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare për shqyrtimin e projektligjit “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”. Institucionet e pavarura që morën pjesë drejtpërdrejtë në këtë Komisioni ishin: Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit, ILDKPKI dhe Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit; ndërsa nga shoqëria civile morën pjesë: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Instituti Shqiptar i Shkencave, Partners Albania dhe Flag. Megjithatë, komentet mbi projektligjit janë prezantuar edhe nga OSCE, EUD etj.

MSHÇV, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë si bashkë propozues të projektligjit, kanë shqyrtuar komentet e marra nga të gjitha palët e interesuar dhe reflektuar ato në projektligj.

Më datë 29 dhe 30 mars 2016, projektligji u miratua në parim dhe nen për nen në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Projektligji u miratua gjithashtu në Kuvend dhe hyn në fuqi në Tetor 2016 (shënim: ky ishte një angazhim i Planit të Veprimit 2014 - 2016). Produkte të synuara të këtij angazhimi:

- Hartimi i akteve nënligjore, udhëzimeve përkatëse dhe formave të raportimit të ndjekjes dhe investigimit nga ILDKPKI për zbatimin e suksesshëm të këtij ligji;
- Konsultime me grupet e interesit në Tiranë dhe rrethë për prezantimin e akteve nënligjore, diskutimin dhe marrjen e rekomandimeve prej tyre;
- Ngritje kapacitetesh përmes trajnimeve dhe asistencës teknike për stafin e ILDKPKI dhe administratës publike në lidhje me implementimin e suksesshëm të ligjit dhe akteve nënligjore, përgatitjen e përshkrimit të punës për stafin përgjegjës për marrjen e sinjalizimeve dhe ndjekjen e tyre;
- Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi në media për ligjin dhe rëndësinë e zbatimit të tij në luftën kundër korrupsionit.

LIGJIN PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE		
Institucioni udhëheqës	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore/Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit	
Pjesëmar rës të tjerë	Qeveria	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore/Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit, Ministria e Drejtësisë
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Shoqëria Civile, Media, Biznesi
Status quo ose problemi / çështja që adresohet	<p>Ka përfunduar puna dy vjeçare për hartimin e projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, si një mjet i rëndësishëm parandalues dhe raportues i praktikave korruptive brenda autoriteteve publike dhe subjekteve private. Projektligji është miratuar në Këshillin e Ministrave në 16 dhjetor 2015; në datë 17 shkurt 2016, projektligji u prezantua nga Ministri Çuçi në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku u zhvilluan edhe diskutimet e para në parim mbi përmbajtjen e projektligjit mes anëtarëve të Komisionit (Relatore: V.Hysi) dhe përfaqësuesve të MSHCV-se.</p> <p>Në datë 1 mars 2016, projektligji u diskutua në parim në Komisionin Parlamentar të Sigurisë Kombëtare dhe u miratua në parim.</p> <p>Në datë 7 mars 2016, në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dhe në përputhje me Rregulloren e Parlamentit, u zhvillua seance dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura, organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare për</p>	

	<p>shqyrtimin e projektligjit “Për mbrojtjen e sinjalizuesve”(Relatore: V.Hysi). Institucionet e pavarura që morën pjesë drejtpërdrejtë në këtë Komisioni ishin: Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit, ILDKPKI dhe Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit; ndërsa nga shoqëria civile morën pjesë: Komiteti Shqiptar I Helsinkit, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Instituti Shqiptar I Shkencave, Partners Albania dhe Flag. Megjithatë, komentet mbi projektligjin janë prezantuar edhe nga OSCE, EUD etj.</p> <p>MSHCV, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë si bashkëpropozues të projektligjit, kanë shqyrtuar komentet e marra nga të gjitha palët e interesuar dhe reflektuar ato në projektligj.</p> <p>Më datë 29 dhe 30 mars 2016, projektligji u miratua në parim dhe nen për nen në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.</p> <p>Projektligji u miratua nga Kuvendi dhe hyn në fuqi në muajin Tetor 2016. Gjithashtu pritet: (i) nxjerrja e akteve nënligjore; (ii) forcimi i kapacitetit të ILDKPKI me 7-8 persona që do të zbatojnë projektligjin.</p> <p>Hartimi i këtij projektligji u bë në kuadër të përmbushjes së Udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 330, datë 28.5.2014 dhe në përmbushje të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020 , miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 247, datë 20.3.2015. Ky ligj sanksionon krijimin e një mekanizmi të ri denoncimi dhe goditje të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e punës nga punonjësit e një autoriteti publik apo subjekti privat në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Janë disa faktorë kryesorë që do të ndikojnë në mirëqeverisjen e institucioneve publike dhe private, rritjen e transparencës për publikun dhe dekurajimin e praktikave korruptive si pasojë e miratimit të këtij projektligji: (i) nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat e denoncimit dhe parandalimit të korrupsionit në vendin e punës; (ii) rritja e transparencës në aktivitetet e administratës publike dhe sipërmarrjeve private; (ii) inkurajimi i bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë; dhe (iii) mbrojtja e sinjalizuesve ndaj masave hakmarrëse.</p>				
Objektivi kryesor	Rritja e numrit të denoncimeve për rastet e korrupsionit në autoritetet publike dhe mbrojtja e informatoreve				
	Permiresimi I sherbimeve publike	Administrimi me efikas I burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e pergjegjshmerise se korporatave	Krijimi I nje komuniteti me te sigurt
		X	X	X	X

Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi					
Eshte e rëndesishme per permiresimin e:	Transparencës	Përgjegësisë		Pjesëmarrjes Qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X	X		X	
Vleresimi: <i>Transparencës</i> <i>Llogaridhenie</i> <i>Pjesëmarrjes qytetare</i> <i>Tech dhe Inovacion</i>	<p>Ligjin Për mbrojtjen e Sinjalizuesve eshte nje angazhim shume i pershtatshem per rritjen e transparencës dhe dekurajimin e praktikave korruptive.</p> <p>Ky angazhim permbush kriterete e transparences dhe llogaridhenies.</p> <p>Nderkohe, duhen sqaruar disa detaje qe nuk jane te qarta nga pershkrimi i angzhimit te, si menyra e parashikuar per nderlidhejen e ligjit me faktorët me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat e denoncimit dhe parandalimit të korrupsionit në vendin e punës; (ii) rritja e transparencës në aktivitetet e administratës publike dhe sipërmarrjeve private; (iii) inkurajimi i bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë. <p>A do te kete nje fushate sqaruese/promovuese? A do te nderthurret ky ligj me portalin e anti-korrupsionit, duke qene se permenden mekanizma denoncimi, etj.</p>				

3. QEVERISJE E HAPUR PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

3.1 Ofrimi i shërbimeve elektronike

Ky angazhim synon që nëpërmjet një Sistemi menaxhimi formash elektronike (eForms). hartimin dhe dërgimin elektronik të kërkesave për e-Sherbime nga qytetarët me ane te formularëve (eForm-ave). Kjo do të ndihmojë institucionet e përfshira për të zvogëluar punën manuale me letra e cila është më e ngadalte sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur forma elektronike për komunikim me qytetarët. Sistemi gjithashtu do të ndihmojë qytetarët dhe biznesin për të zvogëluar kohën për marrjen e shërbimeve. Koha për përpunimin e formularëve do të reduktohet për shkak se eFormat e dorëzuara do të jenë ne format elektronike. Sistemi do të rrisë efizienzën e punonjësve qeveritarë të cilat do ti shërbejnë me shpejt dhe me mire qytetareve.

Ofrimi i shërbimeve elektronike		
Institucioni udhëheqës		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Ministritë e Linjes dhe institucione e tyre te varesise, pushteti lokal, institucionet e pavarura Në total: mbi 85 institucione qe ofrojne sherbime nepermjet portalit e-albania
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Qytetarët/biznesi/punojesit e administrates publike Ne total: 214.041 përdorues të regjistruar (qytetare/biznese) Përdorues: Punojes te administrates publike rreth 15.000
Status quo ose problemi/çështja që adresohet		Aktualisht në portal ofrohen 248 shërbime elektronike niveli 3-4. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit synon ndërtimin e një Sistemi menaxhimi formash elektronike (eForms). Ky projekt ka si qëllim hartimin dhe dërgimin elektronik të kërkesave për eSherbime nga qytetarët me ane te formularëve (eForm-ave). Kjo do të ndihmojë institucionet e përfshira për të zvogëluar punën manuale me letra e cila është më e ngadalte sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur forma elektronike per komunikim me qytetarët. Sistemi gjithashtu do të ndihmojë qytetarët dhe biznesin për të zvogeluar kohen për

martjen e shërbimeve. Koha për përpunimin e formularëve do të reduktohet për shkak se eFormat e dorëzuara do të jenë në format elektronike . Sistemi do të rrisë eficienten e punonjësve qeveritarë të cilat do ti shërbejnë me shpejt dhe me mirë qytetareve.

Gjithashtu, AKSHI ka ndermarre projektin për dixhitalizimin e 36 shërbimeve të MPJ.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është:

1. publikimi dhe elektronizimi i shërbimeve të ofruara nga Ministria e Punëve të Jashtme si dhe nga Perfaqësia Diplomatike dhe Konsullore në portalin e shërbimeve unike qeveritare e-albania.al

2. përshtatje të faqeve të internetit të çdo konsullate me elementet: trokitje virtuale, tur virtual në 3D për çdo konsullatë, video e ministrit të MPJ ku i mirepret vizitorët dhe i orienton në paketën e shërbimeve.

Një tjetër projekt që pikas është shërbimi elektronik i lejeve. Ky shërbim elektronik ofron mundësinë e aplikimit online për leje ndërtimi nëpërmjet Portalit e-Albania për llojet e mëposhtme të lejeve:

- Aplikim për lëshimin e një leje zhvillimi;
- Aplikim për lëshimin e një leje ndërtimit sipas kategorisë duke përfshirë leje për një ndërtim të ri, prishje ndërtimi apo shtesë në ndërtimin ekzistues;
- Kërkesë për lëshimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh;
- Kërkesë për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit;
- Aplikim për lëshimin e lejes për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit;
- Aplikim për lëshimin e lejes për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësisë individuale;
- Kërkesë për lëshimin e certifikatës së përdorimit.
- Kërkesë për plotësim dokumentacioni
- Aplikim për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit

Veshtiresite kryesore të hasura për projektet e mësipërme janë mungesa e një

	sistemeve te informatizuara ne disa prej institucioneve				
Objektivi kryesor	Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në portalin qeveritar e-Albania <ul style="list-style-type: none"> • Do te zvogelohet puna manual me letra per institucionet e përfshira e cila është më e ngadalte sesa perpunimi elektronik i informacionit duke perdorur forma elektronike per komunikim me qytetaret; • Ulje e koston dhe kohes se sherbimeve per qytetaret dhe vete administraten; • Sherbime publike me te mira per qytetarin; • Ulje te korrupsionit. 				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
	mbi 390 shërbime elektronike brenda vitit 2016.				
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X				X
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	
Numri i shërbimeve elektronike të shtuara në e-albania	Angazhim në vazhdim	2016		Dhjetor 2017	

3.2 Krijimi i sistemit multifunksional të qëndëruar për lejet e ndërtimit

Ky angazhim parashikon ndërtimin i një sistemi multifunksional për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje ndërtimi dhe zhvillimi duke dhënë mundësinë që qytetaret dhe bizneset të aplikojnë online. Qëllimi i këtij projekti është ndërtimi i një sistemi multifunksional dhe të qëndëruar për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje zhvillimi dhe ndërtimi, duke iu dhënë mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë online. Duke qenë një sistem i qëndëruar synohet që të aksesohet në mënyrë elektronike nga të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe të gjithë institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet llogarive përkatëse. Ky projekt synon realizimin e komunikimit elektronik të regjistrat të AKPT-së me regjistrat elektronikë të institucioneve të tjera për verifikime apo marrje automatike të të dhënave të aplikantëve, nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, si dhe gjurmimin e statusit të aplikimit në çdo fazë të tij nëpërmjet sistemit e-Tracking.

Krijimi i sistemit multifunksional të qëndëruar për lejet e ndërtimit		
Institucioni udhëheqës	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njesite e qeverisjes vendore
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Ne bashkëpunim me sektorin privat, Bizneset, zhvilluesit, ndërtuesit.
Status quo ose problemi/çështja që adresohet	Krijimi i sistemit multifunksional të qëndëruar për lejet e ndërtimit do të ridimensionojë totalisht ofrimin e këtij shërbimi për biznesin shqiptarë. Sistemi i prezantuar për herë të parë në qeverinë shqiptare do të përfshijë aplikimin për leje zhvillimi, trajtimin e aplikimeve nëpërmjet sistemit totalisht online. Mjaft e rëndësishme të theksohet është bashkëpunimi i ngushtë me pushtetin lokal për realizimin e këtij sistemi multifunksional të qëndëruar.	
Objektivi kryesor	Ndërtimi i një sistemi multifunksional për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje ndërtimi dhe zhvillimi duke dhënë mundësinë që qytetaret dhe bizneset të aplikojnë online. Qëllimi I këtij projekti është ndërtimi i një sistemi multifunksional dhe të qëndëruar për të lehtësuar procedurat e aplikimeve për leje zhvillimi dhe ndërtimi, duke iu dhënë	

	mundësinë qytetarëve dhe bizneseve të aplikojnë online. Duke qenë një system i qendëruar synohet që të aksesohet në mënyrë elektronike nga 61 NJQV dhe të gjithë institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet llogarive përkatëse. Ky projekt synon realizimin e komunikimit elektronik të regjistrimit të AKPT-së me regjistrat elektronikë të institucioneve të tjera për për verifikime apo marrje automatike të të dhënave të aplikantëve, nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit, si dhe gjurmimin e statusit të aplikimit në cdo fazë të tij nëpërmjet sistemit e-Tracking. Nëpërmjet këtij projekti synohet edhe përshtatja e regjistrimit aktual në përputhje me ndryshimet më të fundit ligjore si dhe përmirësimi i funksionaliteteve aktuale të regjistrimit elektronik dhe sistemit GIS.				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
	X				
Është e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X				X

3.3 Prezantimi dhe shtimi i sporteveve digjitale

Nëpërmjet shpërndarjes së sporteveve digjitale, portali unik qeveritar e-Albania synon të ofrojë akses dhe kërkim më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët shqiptarë të cilët mund të drejtohen në një pikë të vetme aksesi publik për të marrë informacion apo shërbimet publike online që ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania. Sportelet digjitale të shërbimeve publike do të ofrojë nëpërmjet automatit shërbime publike 24/7.

Me anë të kioskave digjitale bëhet e mundur që shërbimet e ofruar nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania të kenë mundësi aksesit nga të gjithë qytetarët shqiptarë.

Prezantimi për herë të parë i kioskave digjitale do sjellë rritje të transparencës për shërbimet e ofruar nga administrata. Në këtë mënyrë, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike synohet të përmirësohet disponueshmëria, cilësia dhe transparenca e shërbimeve publike si dhe të reduktohet koha e zbatimit të procedurave dhe kostot e administratës publike.

Prezantimi dhe shtimi i sporteve dixhitale		
Institucioni udhëheqës		Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat
Status quo ose problemi/çështja që adresohet		<p>Me qëllim përmirësimin e shërbimeve ngaj qytetarit si dhe me qëllim promovimin e teknologjive me të fundit, AKSHI ka ndërmar iniciativën për të përhapur në vendin tone kioskat dixhitale. Me anë të kioskave digjitale bëhet e mundur që shërbimet e ofruar nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania të kenë mundësi aksesit nga të gjithë qytetarët shqiptarë.</p> <p>Prezantimi për herë të parë i kioskave dixhitale do sjellë rritje të transparencës për shërbimet e ofruar nga administrata. Në këtë mënyrë, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike synohet të përmirësohet disponueshmëria, cilësia dhe transparenca e shërbimeve publike si dhe të reduktohet koha e zbatimit të procedurave dhe kostot e administratës publike.</p>
Objektivi kryesor		Nëpërmjet shpërndarjes së sporteve dixhitale, portali unik qeveritar e-Albania synon të ofrojë akses dhe kërkim më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët shqiptarë të cilët mund të drejtohen në një pikë të vetme aksesit publik për të marrë informacion apo shërbimet publike online që ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania. Sporteli dixhital i shërbimeve publike do të ofrojë nëpërmjet automatit shërbime publike 24/7.

	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	X		X		
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X				X
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit
Numri i sporteve digjitale	Angazhim i ri	2016		2017	11 sporte të instaluar në pikat e parashikuara

3.4 Standardizimi i Kartelës Informuese

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, ka si angazhim përgatitjen e kartelave informative për çdo shërbim administrativ, bazuar në përvojën me standardet e ofrimit të shërbimit ndaj klientit në sektorin privat. Ky angazhim vjen si rezultat i reformës për shërbimet publike, bazuar në mungesën e informacionit të nevojshëm, transparencës, përgjegjshmërisë si dhe efijencës për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë,

Kartela Informative do të jetë në funksion të gjithë qytetatëve të Republikës së Shqipërisë për shpërndarjen, thjeshtëzimin si dhe unifikimin e informacionit, për të gjitha shërbimet publike. Kjo do të sjellë një pasqyrë të qartë tek qytetaret për mënyrën e lëvrimin të shërbimeve publike. Çdo shërbim ka

kartelën e tij unike, ku shprehen të dhënat që lidhen me emrin e institucionit, emërtimin e shërbimit, kodin, përshkrimi, dokumentacioni i nevojshëm, dokumenti që përftohet, afati i vlefshmërisë së këtij dokumenti, përfituesit e shërbimit, koha e marrjes së shërbimit, tarifa, mënyra e pagesës, ofrimi i shërbimit online, baza ligjore, adresa e zyrave, sistemi i ankesave, përshkrimi i procedurës së aplikimit në zyrën pritëse, call center.

Objektivi kryesor i Kartelave Informative është:

- thjeshtëzimi i informacionit për qytetarët për mënyrën e përfitimit të shërbimeve publike;
- unifikimi i organizimit të informacionit për shërbimet publike;
- standardizimi i tij, me qëllim përdorimi jo vetëm në zyrat pritëse por edhe në Call Center dhe në portalin online qeveritar E-Albania.

Aktualisht ADISA ka në fokusin e saj 10 Institucione dhe po punon për përfundimin e 400 kartelave informative të cilat janë në fazën e fundit të rregullimeve dhe rakordimit me Institucionet që i lëvrojnë.

Në vijim do të punohet për standardizimin e 700 Kartelave Informative të dakortësuara me institucionet që ofrojnë shërbime publike, të cilat do të përfundojnë në fund të vitit 2017.

Standardizimi i Kartelave Informative		
Institucioni udhëheqës		Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Ministri Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike si dhe Ministrinë e Linjes
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Me impakt të gjërë në shoqërinë civile dhe sektorin privat.

<p>Status quo ose problemi/çështja që adresohet</p>	<p>Standardizimi i Kartelës Informative bëhet nga ADISA bazuar ne Ligjin Nr. 13, date 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", dhe në VKM Nr. 343, datë 04.05.2016”Për përcaktimin e Autoritetit përgjegjës për hartimin e modeleve”.</p> <p>Në lidhje me sa më sipër, ADISA bashkëpunon me institucionet e administratës shtetërore që ofrojnë shërbime publike në sportel për marrjen e informacionit përkatës, pra përmbajtjes së Kartelës Informative.</p> <p>Për çdo shërbim qe do të standartizohet Kartela Informative përkatëse e cila do të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kodi i shërbimit; b) Emërtimi i shërbimit; c) Dokumentacionin e nevojshëm për shërbimin që kërkoni; d) Tarifën e shërbimit; e) Afati kohor i lëvrimit të shërbimit nga Institucioni. <p>Aktualisht është dakortësuar në standartizimin e 371 Kartelave Informative për shërbimet e ofruara nga 10 institucione shtetërore.</p> <p>Ne vijim do të punohet për standardizimin e 700 Kartelave Informative, të dakortësuar me institucionet që ofrojnë shërbime.</p> <p>Kartela do te jete e aksesueshme online si dhe ne sportelet e sherbimit.</p>				
<p>Objektivi kryesor</p>	<p>Kartela Informative ka për qëllim të shërbejë si një një dokument public unik për të rritur transparencën, qasjen qytetare, shpejtësinë e shërbimit, lëvrimin e shërbimit, përmirësimin e vazhdueshëm, performancën dhe ofron mjete alternative për të luftuar korrupsionin.</p>				
<p>Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi</p>	<p>Përmirësimi i shërbimeve publike</p>	<p>Administrimi më efikas i burimeve publike</p>	<p>Rritja e integritetit publik</p>	<p>Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave</p>	<p>Krijimi i një komuniteti të sigurt</p>
			<p>X</p>		

	Transparencës	Përgjegjësisë	Pjesëmarrj es qytetare	Teknologji dhe inovacion
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	X	X		
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit	Data e mbarimit	Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përbushjen e angazhimit
• Numri i kartelave informative do të shërbejë si indikator	Angazhim i ri	2016	2017	700 kartela

3.5 Karta e Qytetarit

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në bashkëpunim me Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ka ndërmarrë krijimin e një dokumenti publik, i cili, për herë të parë, do t'u sigurojë dhe garantojë qytetarëve dhe institucioneve, informacion mbi standardet bazë për ofrimin të shërbimeve publike në sportel. Informacion i cili më parë nuk dihej nga institucionet dhe qytetarët.

Këtë angazhim do ta përmbushi ADISA, si autoriteti përgjegjës për standardizimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike në sportel, duke krijuar Kartën e Qytetarit.

Në kartën e qytetarit do të përfshihet për çdo shërbim informacioni bazë për mënyrat/kanalet për marrjen e shërbimit:

- rregullat e sjelljes në sportelet fizike;
- rregullat për aplikimin e shërbimeve në sportelet fizike;
- rregullat për marrjen e përgjigjeve në sportelet fizike;
- rregullat për ankim;
- modelet e paraqitjes vizuale të sporteleve fizike;
- elementet e domosdoshme të shërbimit në sportelet fizike;
- rregullat e komunikimit dhe të organizimit të informacionit mbi shërbimet;
- rregullat për mënyrën e përdorimit të formave dhe funksionalitetin e kanaleve të ndryshme të ofrimit të shërbimeve publike në këndvështrimin e personave fizikë dhe juridikë;
- klasifikimin e shërbimeve;
- kodifikimin e shërbimeve;
- formularët për aplikimin në shërbime.

Formulimi dhe publikimi gjerësisht i kartës në format të printuar apo elektronik do të garantonte rritjen e transparencën, shpejtësinë e shërbimit, lëvrimin e shërbimit, përmirësimin e vazhdueshëm, performancën dhe ofron mjete alternative për të luftuar korrupsionin.

Karta e Qytetarit		
Institucioni udhëheqës		Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara
Pjesëm arrës të tjerë	Qeveria	Ministri Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike si dhe Ministrinë e Linjes
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Me impakt të gjërë në shoqërinë civile dhe sektorin privat

<p>Status quo ose problemi/çështja që adresohet</p>	<p>Hartimi i Kartes se Qytetarit bazohet në Ligjin Nr. 13, date 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", Neni 35, ku përcaktohet se:</p> <p>Standardizimi i mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike në sportel bëhet sipas modeleve kombëtare, si dhe modeleve europiane dhe ndërkombëtare, të cilat hartohen dhe përshtaten si modele shqiptare nga autoriteti përgjegjës për modelet, i cili bazuar ne VKM Nr. 343, date 04.05.2016 është ADISA.</p> <p>Termi "modele" nenkupton:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) rregullat e sjelljes në sportelet fizike; b) rregullat për aplikimin e shërbimeve në sportelet fizike; c) rregullat për marrjen e përgjigjeve në sportelet fizike; ç) rregullat për ankim; d) modelet e paraqitjes vizuale të sporteve fizike; dh) elementet e domosdoshme të shërbimit në sportelet fizike; e) rregullat e komunikimit dhe të organizimit të informacionit mbi shërbimet; f) rregullat për mënyrën e përdorimit të formave dhe funksionalitetin e kanaleve të ndryshme të ofrimit të shërbimeve publike në këndvështrimin e personave fizikë dhe juridikë; g) klasifikimin e shërbimeve; h) kodifikimin e shërbimeve; gj) formularët për aplikimin në shërbime. <p>Çdo standard përbëhet nga disa procese, që garantojnë standardin në vetvete. Proceset shoqërohen me aktivitete të caktuara, të cilat duhen ndërmarrë për të garantuar standardet. Në fund, proceset maten përmes indikatorëve (treguesve), nëse standardet janë në nivelet e duhura.</p>				
<p>Objektivi kryesor</p>	<p>Karta e Qytetarit ka për qëllim të shërbej si një një dokument publik për të rritur transparencën, qasjen qytetare, shpejtësinë e shërbimit, lëvrimin e shërbimit, përmirësimin e vazhdueshëm, performancën dhe ofron mjete alternative për të luftuar korrupsionin.</p>				
	<p>Përmirësimi i shërbimeve publike</p>	<p>Administrimi më efikas i burimeve publike</p>	<p>Rritja e integritetit publik</p>	<p>Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave</p>	<p>Krijimi i një komuniteti më të sigurt</p>

Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi					
	X		X		
Është e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrje s qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X	X			
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit
<ul style="list-style-type: none"> Numri i shërbimeve për të cilat standartizohet karta e qytetarit do të shërbejë si indikator 	Angazhim i ri	2017		2018	

3.6 Sistemi elektronik i regjistrimit të recetave elektronike në Republikën e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë

Ky angazhim synon të zëvendësojë recetën mjekësore në letër me recetë elektronike në rang kombëtar. Përmbushja e këtij angazhimi sjell rritje të efikasitetit të fondeve të rimbursimit të barnave mjekësore si dhe saktësinë e përcaktimit të barnave mjekësore duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shëndetit të pacientëve dhe kujdesit shëndetësor.

Midis të tjerave, e-receta do të sjellë:

- Ulje të mundësisë e gabimeve që vijnë si pasojë e keqkuptimeve në shkrim midis mjekëve dhe farmacistëve;

- Ulje të kohës administrative të komunikimit midis: pacient – mjek, pacient – farmacist, farmacist – FSDKSH;
- Rritje te nivelit te pajtueshmërisë së barnave të dhëna për një pacient si dhe të rrisë dhe komoditetin e vetë pacientit në aksesimin e këtyre ilaçeve;
- Sistemi do mundësojë krijimin e një regjistri historik të mjekimeve faktike që pacienti ka marrë.

Përsa i takon saktësimeve mbi recetat, pasi me anën e këtij sistemi recetat janë online dhe mund të shfletohen nga farmacistët.

SISTEMI INFORMATIK I REGJISTRIMIT TË RECETAVE ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË		
Institucioni udhëheqës	Ministria e Shëndetësisë	
Pjesëmarrës të tjerë	Qeveria	Ministria e Shëndetësisë
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Farmacite
Status quo ose problem/çështja që adresohet	<p>Deri më tani, gjenerimi i recetave mjekësore kryhet vetëm në letër. Duke qenë se volumi i informacionit të perpunimit të recetave në letër për t'u menaxhuar nga institucionet shëndetësore është rritur ndjeshëm, atëherë Ministria e Shëndetësisë pas pilotimit me sukses te sistemit te recetes elektronike ne rrethin e Durrësit, po e shtrin kete sistem në të gjithë Shqipërinë.</p> <p>Mungesa e një regjistri informatik për regjistrimin e recetave të lëshura nga mjekët favorizon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mundësinë e lartë të kryerjes së gabimeve • mundësi gabimi dhe interpretimi në dhënien e barnave • kërkon volum shumë të madh pune me recetat në letër • punë shumë e madhe në data entry të recetave në letër në një regjistër për llogaritjen e rimbursimeve të farmacive për barnat e rimbursueshëm. • Etj 	
Objektivi kryesor	<p>Objektivi i këtij ështëzëvendësimi i recetës mjekësore në letër me recetë elektronike në rang kombëtar. Përmes këtij sistemi synohet të arrihet ne:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rritje të efikasitetit të fondeve të rimbursimit të barnave mjekësore si dhe saktësinë e përcaktimit të barnave mjekësore duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shëndetit të pacientëve dhe kujdesit shëndetësor. 2. Ulje të mundësisë së dhënies së barnave mjekësore të gabuara për 	

	<p>pacientët.</p> <p>3. Ulje të mundësisë e gabimeve që vijnë si pasojë e keqkuptimeve në shkrim midis mjekëve dhe farmacistëve.</p> <p>4. Ulje të kohës administrative të komunikimit midis</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pacient –Mjek • Pacient-Farmacist • Farmacist - FSDKSH <p>për saktësimet mbi recetat, pasi me anën e këtij sistemi recetat janë online dhe mund të shfletohen nga farmacistët.</p> <p>5. Rritje te nivelit te pajtueshmërisë së barnave të dhëna për një pacient si dhe të rrisë dhe komoditetin e vetë pacientit në aksesimin e këtyre ilaçeve.</p> <p>6. Sistemi do mundësojë krijimin e një regjistri historik të mjekimeve faktike që pacienti ka marrë.</p> <p>7. Krijuar lehtësi dhe përfitueshmëri dhe për farmacistët duke</p> <ul style="list-style-type: none"> o Ulur mundësinë e gabimeve o Rritjen e saktësisë në dhënien e barnave o Zvogëluar punën me recetat në letër <p>Etj.</p>				
Sfida e OGP-SË QË PREKET NGA ANGAZHIMI	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurtë
	X	X	X		X
Është e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X	X		X	X

4. QEVERISJE E HAPUR PËR TË MBROJTUR MJEDISIN

4.1 Sistemi elektronik i monitorimit të pyjeve - Ministria e Mjedisit

Ky angazhim ka si objektiv krijimin e një sistemi të integruar që do të mundësojë monitorimin e aktiviteteve të paligjshme dhe identifikimin në kohë të zjarreve, si një nga objektivat strategjike të programit të qeverisë për pyjet.

Ky angazhim ka këto objektiva:

- Krijimin e sistemit të integruar për monitorimin e pyjeve për të parandaluar prerjen e paligjshme të pyjeve;
- Detektimin dhe zbulimin në kohe reale të zjarreve që mund të ndodhin në pikat që do të mbulohen nga sistemi;
- Monitorimin 24 orë në 365 dite të vitit, të pikave kyçe të përcaktuara për parandalimin e prerjeve të paligjshme dhe kontrollin e transportit të materialit drusor nga pyjet në drejtim të qendrave urbane ku ai grumbullohet e tregtohet.
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit për parandalimin e kundërvajtjeve për prerjen e pyjeve;
- Shkëmbim informacioni në kohe reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen e autorëve të veprimeve të kundra ligjshme;
- Uljen e nivelit të korrupsionit në sektorin e pyjeve.

SISTEMI ELEKTRONIK I MONITORIMIT TE PYJEVE		
Institucioni udhëheqës		Ministria e Mjedisit
Pjesëma rrës të tjerë	Qeveria	Ministria e Mjedisit ISHMPU (Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve)
	Shoqëria Civile, Sektori privat	

<p>Status quo ose problemi/çështja që adresohet</p>	<p>Prerja e paligjshme e pyjeve është një nga aktivitetet ilegale me impakte të mëdha në dëmtimin e ekosistemeve pyjore dhe mjedisit në tërësi duke shkaktuar një zinxhir pasojash negative që rezultojnë me dëmtime të rënda për pyjet, tokën dhe ekonominë kombëtare. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme të bëra nga strukturat shtetërore për parandalimin dhe goditjen e këtij aktiviteti përsëri konstatohen probleme në disa rrethe të vendit. Aktualisht Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit , Pyjeve dhe Ujrave nuk ka asnjë sistem informatik për monitorimin dhe regjistrimin e aktivitete ilegale të pyjeve apo zjarreve në çdo qark të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Vendosja e sistemit të monitorimit me kamera dhe krijimi i sistemit të përshtatshëm për analizimin e informacioneve dhe masave reaguese kur konstatohen kalime të paligjshme, do të rrisë ndjeshëm efektivitetin e punës së Inspektoriatit të Policisë Pyjore, evidentimin e provave për fillimin e proceseve për dokumentimin e kundravajtjeve dhe ndëshkimin e autorëve.</p> <p>Ngritja e këtij sistemi do të ulë dhe kostot e inspektimeve dhe një vlerësim më të mirë të punës së Inspektorëve të Inspektoriatit të Policisë Pyjore dhe Rojeve Mjedisore që kanë në përgjegjësi zonat pyjore.</p> <p>Duke qënë se disa nga kamerat do të vendosen në pika dominuese të terrenit dhe në brendësi të Parqeve Kombëtare ato do të shërbejnë edhe si sisteme vrojtimi e zbulimi të zjarreve në pyje.</p> <p>Monitorimi i vazhdueshëm do të ketë impakt dhe në uljen e nivelit të korrupsionit në sektorin e pyjeve.</p>
<p>Objektivi kryesor</p>	<p>Objektivi kryesor i këtij projekti është krijimi i një sistemi të integruar për ISHMPU që të mundësojë monitorimin e aktiviteteve të paligjshme dhe identifikimin në kohë të zjarreve, si një nga objektivat strategjike të programit të qeverisë për pyjet.</p> <p>Ky angazhim ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Krijimin e sistemit të integruar për monitorimin e pyjeve për të parandaluar prerjen e paligjshme të pyjeve; - Detektimin dhe zbulimin në kohe reale të zjarreve që mund të ndodhin në pikat që do të mbulohen nga sistemi; - Monitorimin 24 orë në 365 dite të vitit, të pikave kyce të përcaktuara për parandalimin e prerejve të paligjshme dhe kontrollin e transportit të materialit drusor nga pyjet në drejtim të qendrave urbane ku ai grumbullohet e tregëtohet. -Permiresimin e cilësise së shërbimit për parandalimin e kundravajtjeve për prerjen e pyjeve.

	-Shkëmbim informacioni në kohe reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen e autorëve të veprimeve të kundra ligjshme.				
	-Uljen e nivelit të korrupsionit në sektorin e pyjeve				
	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi		X		x	
	Transparencës	Përgjegjësia		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
Eshtë e rëndësishme për përmirësimin e:	X	X			X
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	
-Ndërtimi i një sistemi të rimonitorimi dhe survejimi me rreth 240 video kamera në 24 pika kyce në të gjithë vendin, që do të monitorojnë kryqëzimet kryesore në të cilat mund të transportohet materiali drusor si dhe të mbulojnë disa zona të mbrojtura përfshirë parqet kombetare për të monitoruar rënien e zjarreve. - Transmetimi i imazheve të filmuara nga kamerat në një server i cili do të jetë pranë zyrave të degëve rajonale të ISHMP-ve, seksioneve të Inspektoriatit të Policisë Pyjore dhe ISHMP Qëndror.	Angazhim i ri.	Gusht 2016		2017	

<p>-Bllokimi i transportit të paligjshëm me impakt të menjëhershëm në ulejn e prerjeve të paligjshme dhe në dekurajimin e kundravajtësve.</p> <p>-Impakt mediatic i menjëhershëm i rezultateve të filmimeve që do të influencojë në reduktimin e veprimtarive të paligjshme në të gjithë territorin e vendit.</p> <p>- Indikator i suksesit do të jetë sasia e materialit drusor të sekuestruar, numri i mjeteve të bllokuara e sekuestruara, numri i gjobave të vendosura, numri i drurëve të prerë ilegalisht.</p>			
--	--	--	--

4.2 Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit - Ministria e Zhvillimit Urban

Aktualisht, në Ministrinë e Zhvillimit Urban nuk ekziston aplikim software që të menaxhojë aplikimet për licencimin profesional në fushat e mësipërme, dhe çdo praktikë aktualisht ofrohet vetëm në letër.

Nëpërmjet këtij projekti synohet ofrimi online i aplikimeve për licencimin profesional nëpërmjet platformës unike qeveritare të ndërveprimit dhe publikimit të këtyre shërbimeve elektronike në portalin unik qeveritar e-albania, duke qenë në përputhje me iniciativat e qeverisë shqiptare për ofrimin e shërbimeve digjitale ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

Sistemi do të përmirësojë shërbimet ndaj qytetarëve, do të lehtësojë procedurat, do përshpejtojë dhe do të rrisë më tej transparencën e sistemit brenda ministrisë, midis ministrisë dhe institucioneve të tjera publike dhe publikut. Sistemi do të shfrytëzojë të gjithë bazën e të dhënave të informacionit dhe të

minimizojë sa më shumë të jetë e mundur ndërhyrjen njerëzore në proces, përgjatë performancës së kontrollit aritmetik dhe logjik.

SISTEMI INFORMATIK I INTEGRUAR PËR LICENCIMIN PROFESIONAL TË INDIVIDËVE DHE SUBJEKTEVE JURIDIKE QË DO TË USHTROJNË VEPRIMTARI NË FUSHËN E STUDIMIT E PROJEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES E KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT		
Institucioni udhëheqës		Ministria e Zhvillimit Urban
Pjesëmarrës të tjerë	Qeveria	Ministria e Zhvillimit Urban
	Shoqëria Civile, Sektori privat	Operatori ekonomik privat, fitues në procedurën e prokurimit
Status quo ose problemi/çështja që adresohet		<p>Ministria e Zhvillimit Urban është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, të strategjive e të politikave (ndër të tjera) dhe në fushën e licencimit profesional të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.</p> <p>Aktualisht, në Ministrinë e Zhvillimit Urban nuk ekziston aplikim software që të menaxhojë aplikimet për licensimin profesional në fushat e mësipërme, dhe çdo praktikë aktualisht ofrohet vetëm në letër.</p> <p>Nëpërmjet këtij projekti synohet ofrimi online i aplikimeve për licensimin profesional nëpërmjet platformës unike qeveritare të ndërveprimit dhe publikimit të këtyre shërbimeve elektronike në portalin unik qeveritar e-albania, duke qënë në përputhje me iniciativat e qeverisë shqiptare për ofrimin e shërbimeve dixhitale ndaj qytetarëve dhe bizneseve.</p> <p>Sistemi do të përmirësojë shërbimet ndaj qytetarëve, do të lehtësojë procedurat, do përshpejtojë dhe do të rrisë më tej transparencën e sistemit brenda ministrisë, midis ministrisë dhe institucioneve të tjera publike dhe publikut. Sistemi do të shfrytëzojë të gjithë bazën e të dhënave të informacionit dhe të minimizojë sa më shumë të jetë e mundur ndërhyrjen njerëzore në proces, përgjatë performancës së kontrollit aritmetik dhe logjik.</p>
Objektivi kryesor		Objektivi kryesor i këtij angazhimi është përmirësimi i shërbimeve ndaj përfituesve të shërbimit në lidhje me licensimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit. Në këtë mënyrë, qytetarët, bizneset dhe palët e interesit do të mund t'i referohen një informacioni të qenësishëm dhe të validuar përsa i takon individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit dhe mbikëqyrjes e

	kolaudimit të punimeve të ndërtimit.				
Sfida e OGP-së që preket nga angazhimi	Përmirësimi i shërbimeve publike	Administrimi më efikas i burimeve publike	Rritja e integritetit publik	Rritja e përgjegjshmërisë së korporatave	Krijimi i një komuniteti më të sigurt
	X	X			
Është e rëndësishme për përmirësimin e:	Transparencës	Përgjegjësisë		Pjesëmarrjes qytetare	Teknologji dhe inovacion
	X	X			
Arritjet e matshme dhe të verifikueshme për përmbushjen e angazhimit	Angazhim i ri apo i vazhduar nga plan veprimi i 2013	Data e fillimit		Data e mbarimit	
<ul style="list-style-type: none"> Shërbimi online i aplikimeve për licensimin profesional nëpërmjet platformës unike qeveritare të ndërveprimit; Shkëmbimi në kohë reale i informacionit për verifikimin e statusit të aplikimit; Përmirësimi i kapaciteteve për monitorimin. 	Angazhim i ri	Maj 2016		2017	